

K O N V E N T E

EKSTRADIMI MIDIS SHQIPËRISË DHE BRITANISË SË MADHE

Shkëlqesia e Tij Kryetar' i Republikës Shqiptare

Edhe madhërija e tij Regji i mbretërisë së Bashkuar Britanis Madhe dhe Irlandës edhe i Dominioneve Britanike përtej Deteve, Imperatori Indjes; mbasi kanë vendosun me akord të bashkët, të bëjnë një traktat për ekstradicjonin e kriminelve, kanë emëruar për këtë qëllim, si përfaqësues, fuqiplotë të tyre:

Shkëlqesia e Tij Kryetar' i Republikës Shqiptare:

Zotni Kyssen Vrioni, Ministri i Punëve të Jashtme dhe zëvendës Ministri i Drejtësisë;

Dhe Madhërija e tij Regji i Mbretërisë Bashkuar Britanis Madhe dhe Irlandës edhe i Dominioneve Britanike përtej Deteve, imperator i Indjes:

Zotni W. B. O'Riilly, Envoyé Extraordinaire et Ministre Plénioptenaire të Tij pranë Qeverisë Republikës Shqiptare:

Të cilët mbasi q' i parashtruan, njeni-tjetrit dokumentat fuqiplotëse të tyre dhe të cilët i gjetën në formën e duhur dhe të mirë, u muaznë vesht mbi artikujt qi vijojnë:

Art.1. - Anet kontraktuese të karta lidhen t' i dorëzojnë njena-tjetrës, nën disa raste dhe kondita që përmenden në këtë traktat, ato njerëz të cilët gjinden brënda në token e njenës s' Anë dhe të cilët qenë akuzuar ose dënuar mbrenda në juridiksionin e tjetrës s' Anë për një prej krimeve ose delikteve të përmendun n' art 2 të këtij traktati.

Art.2. - Ekstradicioni do të akordohet reciprokivisht për krimet ose deliktet qi vijojnë:

1. - Vrasje (assassinat, atëvrasje, fëmijvrasje helmosje) ose atentat a konspiration për vrasje.
2. - Vrasje për kast ("manslaughter")
3. - Të dhanunit e barnave ose të përdorunit e veglave moqëllim të shkaktojë dështim ("avortement").
4. - Të rëmbyemit me qëllim turpërimi ("rape").
5. - Turpëruarit ose atentat për të turpëruar një vajzë nën 14 vjeç.
6. - Sjelljet të pa turpshme.
7. - Rëmbesë dhe të burgosunit kundra ligjit.
8. - Të vjedhunit të imive si kundër dhe të lenit, të diftuemit në publik ose të mbajtunit jashtë ligjës.
9. - Abdukujon.
10. Ruljani.
11. - Bigami.
12. - Të plagosunit me qëllim, ose damprurje trupit.
13. - Sulm me damprurje trupnore.
14. - Të frikësuarit me letër ose me tjera mjete, me qëllim të çkëpu

të holla ose gjëra të tjera me vlerë.

15. - Bé e remë ose të shtymit për bé të remë.

16. - Zjarr-vënje.

17. - Kusari ose hyrje me ndonji shtëpi për vjedhje, kusari dhe të prishun me forim vjedhje besimi dhe vjedhje të hollash besuara.

18. - ("Fraad") Mashtrim nga ana e një njeriu të ngarkuar për të bërë një punë e një agjenti, banqeri, faktori, administratori, direktori antari ose ofiqali publik të ndonji kompanije, gjithashtu, konvertim fraudolese.

19. - Të marit e të hollave, sigurime të vlefëshme ose sende të tjera me pretendim të remë, dhe pronje të hollash, sigurime të vlefëshme dhe pasuni me dijeni se janë të vjedhuna e të marruna me të gënjyer.

20. - (a) Remësim ose jaterim i të hollave ose venit në qarkullim të hollat të ramsuara ose të jatërsuara.

(b) Të bërit tue ditë pa autoritet ligjuer e çdo far vegël ose maqine të adoptuara me qëllim për të falsifikuar a imituar monedhat e mbretërisë.

21. - Falsifikim ose përhapje e gjasë së falsifikuar.

22. - Krime kundra ligjës për faliment.

23. - Qdo akt i bërë me qëllim keq-dashje që të vërë në rrezik sigurimin e njerëzve që udhëtojnë ose që gjinden në udhë të hekurit.

24. - Dëmtimi me keqdashje kundra pronjeve, në asht se ky dëmtim e ndiqet prej ligjës.

25. - Piraterija dhe krime ose delikte të tjera që bëhen në det kundra njerëzve ose plaçkave, të cillat krime ose delikte mbas nomevet të Anëvet kontraktuëse të Malta, janë krime ose delikte ekstradicjoni.

26. - Tregëtija e skelevet në mënyrë të tillë që formon një krim ose delikt kundra nomevet e të dy Shteteve.

Ekstradicjoni akordohet dhe për participim për ndonjë prej krimevet ose delikteve të shënuara në sipër në qoftë se participimi kësodore asht i dënuarshëm prej nomeve të dy Partive Kontraktuëse të Iarta.

Ekstradicjoni mund të akordohet gjithashtu në qoftë se Shteti të cilit i bëhet kërkesa e gjenë t'arësyeshme, për ç' do tjetër krim ose delikt, për të cilën dorëzimi mund të bëhet simbas ligjit në fuqi e të dy naltpërmendun Partive Kontraktuëse.

Artikulli 3. - Qdo anë i rezervon të drejtën të refuzojë ose të pranojë dorëzimin e shtetasve ose të qytetarvet të vet njëj tjetrit.

Artikulli 4. - Ekstradicjoni nuk do të bëhet në qoftë se personi që kërkohet është gjykuar dhe çkarkuar ose dënuar ose është nën gjyq në shtetin ku është dhën kërkesa për krimin ose deliktin për të cilin ekstradicjoni kërkohet.

Në qoftë se personi i lypun mbrenda në Shtet prej të cilit kërkohet

het asht nën gjykim ose dënim, për një tjetër krim ose delikt, ekstradicjoni i tij do të ndalet deri sa të mbarojë gjykimi i tij në fjalë ose të marrë fund dënimi i tij në fjalë.

Artikull 5. - Ekstradicjoni nuk do të bëhet në qoftë se pas të kryerit e krimit o deliktit ose pas nisjes së ndjekjes ose dënimit asht fituar me kalim kohe, simbas nomeve të Shtetit aplikues ose të aplikuem.

Artikull 6. - Një kriminal i aratisur nuk do të dorëzohet në qoftë se krimi ose delikti për të cilin kërkohet dorëzimi i tij ka ndonjë karakter politik, ose në provoft se kërkimi për dorëzimin e tij është bërë me të vërtetë me qëllimin që t'a heqin në gjyq ose t'a dënojnë për një krim ose delikt me karakter politik.

Artikull 7. - Një njeri i dorëzuar as me ndonji mënyrë s'mund të mbahet në burg ose të hiqet në gjyq në Shtetin të cilit iu bë dorëzimi për ndonji krim ose delikt tjetër ose për arsye të tjera, përveç atyreve për të cilat do të jetë bërë ekstradicjoni gjer sa i dorëzuarit të jetë kthyer prapë ose të ketë patur rast të kthehet prapë në Shtetin prej të cilit ka qënë dorëzuar.

Kjo marrëveshtje (stipulation) nuk asht e aplikueshme për krimet dhe deliktet që janë bërë pas ekstradicjonit.

Artikull 8. - Kërkesa për ekstradicjon do të bëhet respektivisht me anën e agjentëve diplomatikë të dy Partive Kontraktuese të Malta.

Kërkesa e ekstradicjonit për një person t'akuzuar lypset të jetë e shoqëruar prej një vendimit gjykatës ("mandat d'arrest") të dalun nga autoritetet kompetente të Shtetit që kërkon ekstradicjonin dhe ky mandat duhet të jetë kështu që sikur krijimi ose delikti në fjalë t'ishte bërë mbrenda në Shtetin prej të cilit kërkohet ekstradicjoni, të konstituojë dhe atje një krim ose delikt.

Në qoftë se kërkesa i përket një njeriu që ka qënë dënuar që përpara duhet të jetë e shoqëruar prej vendimit të dënimit që asht dhënë kundër personit të dënuar prej autoriteteve kompetente të Shtetit i cili bën kërkesën për ekstradicjon.

Një vendim i dhanë në mungesë ("in contumacion") nuk do të quhet si një dënim, po një njeri i dënuar kështu mund të konsiderohet si një njeri i akuzuar.

Artikull 9. - Në qoftë se kërkesa për ekstradicjon është në akord me marrëveshtjen ("stipulation") e sipër përmendun autoritetet kompetente të Shtetit prej të cilit kërkohet duhet t'arestojnë t'aratisunin.

Artikull 10. - Një kriminal i aratisun mund të zihet me një mandat të dhanë prej çdo gjykatës policore, gjykatës paqësore, ose një tjetër autoritet kompetent për njerin prej të dy shteteve, në qoftë se ka të tilla informata ose qarje dhe të tilla prova ose pas asish procedurash, të cilat në mëndjen e autoritetit që ka nxjerrë mandatin justifikon të nxje-

rit e një mandate po qe që, krimi ose delikti tish bërë ose personi t'ish dënuar në atë pjesë të Dominionëve të dy Partive Kontraktuese, në të cillën gjykata si, gjykatës i paqës ose tjetër autoritet kompetent ka (eksercon) juridicjon. Në konformitet me këtë artikull i kërkuari do të lirohet sikur se mbrenda në 30 ditë nuk bahet nga ana e një agjentit diplomatik të Shtetit kërkuës një kërkesë për ekstradicion në konformitet me stipulacionet të këtij traktati.

Gjithë këjo rregull do të aplikohet në rastin e personave t'akuzuar ose të dënuar për ndonjë nga krimet ose deliktet të specifikuem në këtë traktat kur bëhet në det të hapët mbi ndonji anie të njenit ose të tjetrit Shtet e cila anije mund të vijë në një liman të Shtetit tjetër.

Artikulli 11. - Ekstradicioni do të bëhet vetiu në qoftë se prova ("evidence") duket e mjaft pas nomeve të Shtetit prej të cilit kërkohet a se për të justifikuar të hequrit nën gjyq në rastë që krimi ose delikti t'ish bërë në tokën e këtij shteti, ose për të provuar se i burgosuri është gjithë ay njeri që është dënuar nga gjykatore e Shtetit që ka bërë kërkesën, dhe se krimi ose delikti për të cilën është dënuar kriminelin është prej atyre për të cilat ekstradicioni në kohën e një dënimi të tillë mund të akordohet nga ana e Shtetit prej të cilit kërkohet; dhe as ndonji kriminel nuk do të dorëzohet pa shkuar 15 ditë që nga data e burgimit të tij për të pritur mandatin për dorëzimin e tij.

Artikulli 12. - Në qyrjen që do të bëhet sipas marrëveshtjeve ("stipulation") e sipër përmendun autoritetet e Shtetit ku u bë kërkesa do të pranojnë si prova të shëndoshë dëshmitet ose vërtetimet të dëshmorëve të bëra në Shtetin tjetër, ose kopjet e tyre, dhe gjithë kështu mandatat dhe vendimet që vijnë s'andejmi, ose kopjet e tyre, dhe certifikatat ose dokumentat gjyqësor duke treguar faktin e një dënimi, me kondita që të jenë autentike si pason:

1. - Një mandat ose kopje e saj duhet të jetë e nënshkruar prej një gjykatësi ose zyrtari të Shtetit tjetër, ose duhet të jetë e vërtetuar nga ana e një gjykatësi, ose zyrtari të Shtetit tjetër se është një kopje e vërtetuar e mandats si t'a kërkoj rasti.

2. - Dëshmitet ose pohimet ose kopjet e tyre do të jenë të vërtetuar nga dorë e një magistrati gjykatësi ose zyrtari të Shtetit tjetër se janë dëshmitet dhe pohimet origjinale ose që janë kopje të vërteta të tyre, ashtu si t'a kërkojë rasti.

3. - Një certifikatë ose dokument gjyqësor të cillat tregojnë faktin e një dënimi duhet të jetë e vërtetuar nga ana e një gjykatësi, magistrati, ose zyrtari të Shtetit tjetër.

Në çdo mandatë, dëshmi pohim, kopje, certifikatë ose dokument gjyqësor të këtij, duhet të jenë autentikuar qoftë me benë e ndonji dëshmitari, qoftë me vulën zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë a ndonji Ministri

të tjetër Shtetit tjetër ose me ndonji mënyrë tjetër autentifikimi që pranohen aso kohe prej nomit të Shtetit të cilit i është bërë kërkesa për ekstradicjon.

Artikulli 13. - Në qoftë se një njeri që kërkohet nga njëra e Partive kontraktuese të Larta në bazë të këtij traktati, kërkohet edhe prej një ose ma shumë fuqive për shkak të krimeve ose delikteve të tjera të bërë mbrënda në juridikcionin e tyre, ekstradicioni i tij do t'akordohet Shtetit i cili ka dhënë kërkesën më parë se të tjerat përveç se ky në pastë hequr dorë nga kjo kërkesë.

Artikulli 14. - Në qoftë se nuk sillen prova të mjafta për ekstradicjon më dy muaj e sipër prej datës së zënit t'arestuarit, ose mbrënda në një kohë më të gjatë që është caktuar prej Shtetit prej të cilit kërkohet ose prej gjykatores së këtij, i aratisuni do të lihet i lirë.

Artikulli 15. - Të gjithë sendet e zëna të cilat i kish në posesion të vet njeriu që dorëzohet në kohën e zënies së tij dhe çdo send që mund të shërbojë për provë për krimin ose deliktin, do të dorëzohet kur të bëhet estradicjoni gjer në atë masë që jep leje nomi i Shtetit që bën dorëzimin.

Artikulli 16. - Çdo anë kontraktuese e Lartë do të heqë shpenzimet e shkaktuara nga të zënit në tokën e vet nga burgimi dhe nga të shpënit gjer në kufi të vet të njerzvet të cillët mund të ketë pranuar të dorëzojë si mbas këtij traktati.

Artikulli 17. - Marrëveshtjet "stipulations" e këtij traktati do të jenë të zbatueshme deri ku japin leje nomot, në të gjithë Dominionet e Madhnis Tij Britanike përveç dominioneve të vet-qeverisura të shënuara këtu më poshtë domethënë Dominioni i Kanades, Komonvelth i Australisë (zihen mbrënda Papua edhe Norfolk Irland), Dominioni i Zelandës së Re, Bashkimi i Afrikës së Jugut, Shteti i Lirë i Irlandës dhe Newfoundlandes dhe India, me konditë gjithnjë që marrëveshtjet (stipulations) e sipërshënuara do të jenë të aplikuashme në çdo Dominion të sipërshënuar ose në Indje, për të cillat përfaqësonjësi i Madhnis Tij Britanike në Durrës do të japë një notë për Qeverinë e Dominionit ose të Indiës, me qëllim të aplikimit të këtij traktati edhe prap me konditën që të jenë kompetent që të dy Partit Kontraktuese të përfundojnë veç e veç aplikimit e këtij traktati në çdo Dominion të sipërshënuar ose në Indë me anën e një note me këtë qëllim e cilla të mos kapërzojë një vit dhe të mos jetë ma pak se gjashtë muaj.

Artikulli 18. - Kërkesa për dorëzimin e kriminalit t'aratisun, i cili ka gjet refugjin në ndonjë prej Dominioneve, kolonive ose Posesioneve të vet qeveruese të Madhnis Tij Britanike në të cilat zbatohet ky traktat do t'i bëhet qeveritarit të Përgjithëshëm. Qeveritarit ose autoritetit të një Dominjoni, Kolonie ose Posesion vet-qeveruës të tillë nga ana e krye-

nëpunësit konsular të Shqipërisë pranë Dominionit, Kolonisë ose Posesionit vet-qeveruës të tillë.

Në kërkesë e tillë do t'u gjegjte gjithmonë nën dispozicionin e këtij traktati aq sa të jetë e mundur dhe deri ku përmeton ligji i Dominionit, Kolonisë ose Posesionit vet-qeveruës të tillë prej Qeveritarit të Përgjithëshëm, Qeveritarit ose kryeaautoritetit, i cili, me gjith këtë do të jetë i lirë ose të bëjë dorëzimin ose t'ia paraqesin qështjen, Qeverisë së Madhënisë Tij Britanike.

Kërkesa për dorëzimin e një kriminelit t'aratisun që jepet nga ana e një Dominionit, Kolonie ose Posesioni të vet-qeverisun të Madhënis Tij Britanike, do të rregullohet aq sa të jetë e mundur prej rregullave të vendosura në nenet e sipërme të këtij traktati.

Artikulli 19. - Kuptohet se qyshket ("stipulations") e dy neneve të sipërme aplikohen dhe për Protektoratat Britanike të poshtëtreguara sikur të ishin këto; posesione të Madhënis Tij Britanike d.m.th. Protektoratat Bequanaland, Gambia, Kenya, Nigeria, Rhodesia, të veriut, Territoriet veriore të Gelden Coast, Nyasaland, Sierra Leone, Solomon Islands, Somaliland, Svaziland, Uganda dhe Zanzibar, edhe për këto vende (territories), që vijon në respekt të cillave një mandat asht pranue nga ana e Madhënis Tij Britanike për Shoqërin e Kombeve, d.m.th. British Cameroons, British Togoland, vendi (territory) Tanganyika e Palesnë.

Kuptohet prapë se po që se pas të nënshkruarit të këtij traktati shifet e arësyeshme që të ndodhen dispozita e këtij traktati mbi ndonji Protektorat Britanik përveç atyreve që përmenden më sipër, ose mbi ndonji Shtet të mprojtur nga Britania ose mbi ndonji vend për të cilin asht pranue një mandat nga ana e Madhënis Tij Britanike përveç atyreve që përmenden më sipër, për shoqërinë e Kombeve, përban edhe vende (territories) në respekt të cillave mandata ushtrohen në emër të Qeverisë të Madhënis Tij Britanike prej Qeveris të Commonwealth të Australis, të Qeveris të Dominionit të New Zealande dhe të Qeveris të Bashkimit të Afrikës Jugut, qyshket ("stipulations") e dy neneve të sipërme do quhen si t'aplikueshme edhe për Protektoratat ose Shtet pse viset e Mandstuar të tilla që prej datës edhe në mënyrë të shënueshme në notat që këmbëhen me qëllim të zgjatimit të tillë të traktatit.

Veç këtyre kuptohet dhe se dispozitat e këtij traktati që aplikohen për nënshtetas Britanik, do të numurohen si t'aplikueshme, dhe kundrejt vëndasve të çdo Protektorate, të mbrojtur ose vëndi të Mandatuar Britanik në të cillët stipulatat e dy neneve të sipërme aplikohen ose do të aplikohen pas këndeje.

Artikulli 20. - Ky traktat do të hyjë në fuqi dhjetë ditë mbas botimit të tij në konformitet me format e caktuara prej neneve të Partive

kontraktuëse të larta. Mund të marrë fund prej secillës partie kontraktuëse të larta me anë të një notës datë e së cillës të mos kapërcejë një mot dhe të mos jetë përpara gjashtë muaj pas nënshkrimit të këtij traktati.

Traktati do të ratifikohet dhe ratifikimi do të këmbëhet në Tiranë aqë shpejt sa të jetë e mundur.

Për dëshmi të këtyne, përfaqësuesit fuqiplotë të dy anëve kanë nënshkruar këtë traktat dhe kanë vënë mbi të secili vulën e vet.

U bë në Tiranë në dublikat në tekstin Anglisht e Shqip prej të cillëve i pari konsiderohet authoritative, sot ditë 22 Korrik 1926.

Dhe Krahunjtë e tij Regji i Shqipërisë dhe Vazhdojnë firmat. Dhe dhe Irlandës edhe i Detit Britanik përtej deteve, Imperatorit i Indisë Lordi W. J. O'Reilly, ambasadori i Ministrave Përcaktues tainë të tij pranë Qeverisë Republikane shqiptare:

Si cilët shpreh q'1 përshkrimin, njësi-tjetris dokumentet fuqiplotë se të tyre dhe të cilët i sjeten në Tiranë e taktik dhe të mira, e shpreh veçat mbi artikujt që vijojnë:

Art.1. - Anët kontraktuese të larta lidhen v'1 bashkënjohë njësi-tjetris, nën këto raste dhe kushte që përmenden në këtë traktat, ato ajtë të cilët gjenden brenda në tokën e njohur s'Anë dhe të cilët qënd shpreh ose shpreh shpreh v'1 juridiksionin e tjetris s'Anë për një grup krimeve ose deliktëve të përmendur s'artë 2 të këtij traktati.

Art.2. - Shprehimisht do të shprehet reciprocisht për krimet ose deliktet që vijojnë:

1. - Vrasje (assassinat, atëvrasje, fëmijëvrasje helmuese) ego atëvrasje e konspiracion për vrasje.
2. - Vrasje për keq ("murdering")
3. - Në dhunim e bërave ose të përdorimit e veglave meqilin të shprehje shpreh ("abduction").
4. - Në rrahjet në qilin shpreh ("rape").
5. - Durrurit ose atentat për të shprehur një vrasje dhe të vrasje.
6. - Vrasjet të pa shpreh.
7. - Atentat dhe të shprehur shpreh shpreh.
8. - Në vrasjet të shpreh në shpreh dhe të lenit, të shpreh të shpreh ose të shpreh jashtë ligjit.
9. - Shprehja.
10. Kufizim
11. - Siguri.
12. - Në shpreh në qilin, ose shpreh shpreh.
13. - Sola në shpreh shpreh.
14. - Në shpreh në shpreh ose të shpreh shpreh, në qilin të shpreh